



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORI EKZEKUTIV

Nr. 2573 prot.

Tiranë, më 03.12.2025

VENDIM

Nr. 56, datë 03.12.2025

PËR

**PRANIMIN DHE PUBLIKIMIN E DIREKTIVËS SË VLEFSHMËRISË AJRORE
PËR ZBATIMIN E URDHËRIT TË MINISTRIT NR. 79, DATË 15.04.2024**

Në mbështetje të neni 14, pika (ë), të Ligj Nr.53/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil” dhe në zbatim të pikës M.A.303, Pjesa M, Seksioni A, Nën pjesa C, e Urdhrit të Ministrit Nr.79, datë 15.04.2024, për miratimin e rregullores “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionëve dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra”,

V E N D O S A

1. Për zbatimin e Urdhrit të Ministrit Nr.79, datë 15.04.2024, për miratimin e rregullores “Mbi vazhdueshmërinë e vlefshmërisë ajrore të avionëve dhe produkteve, pjesëve dhe pajisjeve aeronautike dhe mbi miratimin e organizatave dhe personelit të përfshirë në këto detyra”, pranohet Direktiva e Vlefshmërisë Ajrore të nxjerra nga EASA, si më poshtë:
 - EASA AD No.: 2025-0268-E: Flight Controls – Elevator Aileron Computer – Replacement, me kod ACAA-DFS-AD-No. 055;
2. Ngarkohet Drejtoria e Standardeve të Fluturimit për ndjekjen e këtij vendimi si dhe njoftimin apo publikimin për zbatim nga operatorët.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit të Aviacionit Civil

DREJTOR EKZEKUTIV

Maksim Et'hemaj

